

**VENDIM**  
**Nr.357, datë 12.5.2010**

**PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË**  
**“UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shkollës private të arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana”, Tiranë, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të organizohet në dy fakultete:

a) Fakultetin e Inxhinierisë dhe Shkencave të Aplikuara, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

i) Inxhinieri civile;

ii) Inxhinieri kompjuterike.

b) Fakultetin e Ekonomisë, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, në:

i) Menaxhim biznesi;

ii) Informatikë ekonomike.

3.Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike dhe me plotësimin e së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet “Diplomë e nivelit të parë” (DNP), në:

i) Inxhinieri civile;

ii) Inxhinieri kompjuterike;

iii) Menaxhim biznesi;

iv) Informatikë ekonomike.

4. Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” të fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6.Shkolla private e arsimit të lartë “Universiteti Metropolitan Tirana” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7.Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**